

MARENGLLEN VERLI**ROLI I HOTIT NË KRYENGRITJEN
E MALËSISË SË MADHE**

Treva e Hotit, e njohur historikisht qysh në Mesjetë* evidentohet në mënyrë të dukshme gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe të kryengritjeve të fillimshekullit XX, që u finalizuan me Shpalljen e Pavarësisë e më pas me krijimin e shtetit shqiptar. Ndonëse një territor relativisht i vogël** dhe i banuar nga një numër jo i madh njerëzish***,

* Emri takohet për herë të parë më 1330. Në shek.XVI, njihen si vendbanime të hotjanëve, Trabonja, Rapsha, Brizda etj., dhe nga fundi i shek.XVIII, Vuksanlekaj. (Franc Nopça, *Fiset e Malësisë së Shqipërisë Veriore dhe e drejta zakonore e tyre*, Tiranë: Botimet “Eneas”, 2013, f. 195). Në një hartë që daton rreth vitit 1800 figuron Liqeni i Hotit (*Atlas Gjeografik i Popullsisë së Shqipërisë*, Tiranë: 2003, f. 73), kurse në hartën e Turqisë Evropiane të Heimroth Kiper-it, të vitit 1853, Hoti figuron qartë jo vetëm si trevë, por aty shënohet edhe ndonjë nga vendbanimet kryesore të tij si Traboini. (Mirela Slukan Altić, *Povijesna Geografija Kosova*, Zagreb: 2008, f. 73).

** Fshatrat Han i Hotit, Kushje, Brigje, Rapshë, sot në Republikën e Shqipërisë dhe Arrë, Dokaj, Traboin, Traboin i vjetër, Dreshaj, Sukruq, Narhelm, Vuksanlekaj, në Republikën e Malit të Zi.

*** Bashkëkohësit evropianë i vlerësonin hotët 400-500 shtëpi. Sipas Wiett-it dhe Hahn-it, 2.500 banorë, sipas Lippih-ut 4180, sipas Baldacci-t 4.500 dhe sipas Nopçës rreth 4.000 banorë. Kurse Hahn-i më 1868, bazuar në statistikat e famullive, fiset e peshkopatës së Shkodrës, të marra së bashku, përkatësisht Hotin, Kastratin, Klementin, Shkrelin, Triepshin, Riollin, Koçajn (Kuçët) dhe Grudën, i llogariste 2118 shtëpi me 14.643 frymë. Sipas llogarive të konsullit austro-hungarez në Shkodër, Lippih, më 1877, ato nxirrnin 2.800 luftëtarë (Lippih vlerësonte 120.000 frymë gjithë popullsinë shqiptare katolike nga Tivari në Durrës e deri në Pejë, e cila, sipas tij, mund të nxirrte gjithsej 18.000 luftëtarë) (Shih: F.Nopça, *Fiset e Malësisë...*, f. 183-245; si dhe Marenglen Verli, “Situata demografike, fetare, etnike, ekonomike, etj., në viset e “Shqiptarëve të Veriut”, në vitin 1877, sipas konsullit austro-hungarez, Lippih”, *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë: 2009, f. 355). Me interes është edhe vlerësimi i Nikolla Ivanajt për popullsinë dhe krerët e Malësisë së Madhe dhe të Malësisë së Gjakovës. Ai jepte këto të dhëna: Hoti – 7.000 frymë, të gjithë të fesë katolike (krerët: Deli Meta dhe Dedë Gjon Luli), Gruda – rreth 2.000 (bajraktar formal Dedë Nika, kurse faktik Sokol Baci që

treva dhe fisi i Hotit ndeshen jo rrallë në dokumentacionin diplomatik të asaj periudhe. Gjatë sundimit osman Hoti, edhe pse nuk nxori kurrë më shumë se 300-500 luftëtarë, çmohej si bajrak i parë në kuadër të fiseve të Malësisë së Madhe, dhe kishte privilegjin që në betejë të rreshtohet në krahun e majtë të ushtrisë osmane*.

Më 1901 Baldacci i vlerësonte hotjanët si mikpritës, krenarë, trima, të mirë, të qetë. F. Nopça, të besës, por sipas San Giulianos ishin edhe anarkistë**. Në momentet kruciale për të ardhmen e kombit Hoti la emër veçanërisht, duke marrë pjesë në realizimin e veprave më të shquara kombëtare, ato të pavarësimit dhe shtetformimit të Shqipërisë. I udhëhequr nga burra të shquar, ndër të cilët në dokumentacion spikat veçanërisht Dedë Gjo Luli (rreth 40-vjeçar në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe 71-vjeçar më 1911-1912), Hoti diti të orientohet drejt dhe të kryejë më së miri detyrën e vet, në zonën me emër të Malësisë së Madhe***.

mbahet me subvencionet e Malit të Zi), Kastrati rreth 3.000 (Dedë Preni), Shkreli – 2.500 (Vatë Marashi), Kelmendi – rreth 8.000 (Gjon Uci, Lan Turku, Gjokë Ujka dhe Lish Sokoli), Shala, 5.000 (Prel Marku, Bacë Vata dhe Buç Vata në krye të Djelmënisë së Shalës), Shoshi 2.000 (Gjelosh Kola), Nikaj – 4.000 (Sokol Bacë Bajrami, Shyt Brahimi, Deli Bajrami), Merturi – 2.500 (Bekë Delia, Dedë Trimi), Krasniqja dhe Gashi – rreth 7.000 (Shaban Binaku, i biri i Binak Alisë, vëllam i Mark Milanit dhe i Lekë Kapidanit, gjysh i N.Ivanajt. *Arhiv Jugoslavije (AJ)*, Fondi Jovan Jovanovic, k.3; letër e N.Ivanajt nga Shkupi, 14.X.1909, për kryediplomatin e Serbisë, Millovanoviçin).

* Sipas gojëdhënës këtë nder ia detyronin heroizmit të Uk Lucit, që nga fundi i shek.XVII, kishte marrë pjesë në pushtimin e Ulqinit (1696), dhe më pas ishte kthyer në mysliman. Sipas Nopçës, bajraktarët që rrodhën nga dera e tij, ndonëse myslimanë, festonin çdo 29 gusht Shën Gjonin, dëgjonin meshën e pastaj shtronin gosti. (F.Nopça, *Fiset e Malësisë...*, f. 21, 121, 195-197).

** F. Nopça, *Fiset e Malësisë...*, f. 23, 28, 35. (Shih grindjen më 1911 të hotjanëve me kelmendasit për therjen e një gjeli pa leje, f. 40).

*** Në kohën që në Kongresin e Berlinit diskutohet sakrifikimi i viseve shqiptare për të shpërblyer Malin e Zi, banorët e Malësisë së Shqipërisë Veriore dërguan një protestë. Për Hotin kishte nënshkruar bajraktari Çun Mulaj (për Kelmendin Marash Tuçi e gjithashtu, edhe dy mirditas). Në fund të qershorit në një mbledhje të përgjithshme të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ishin të pranishëm edhe bajraktarët e Malësisë, ndër ta ai i Hotit. Por hotjanët reagues veçanërisht fort më 1879, kur Fuqitë e Mëdha në Berlin diskutuan që, në vend të Plavë Gucisë, Malit të Zi t'i jepej pllaja e sipërme e luginës së Cemit, një pjesë e truallit të Hotit dhe të Vermoshit. Për t'i mbajtur të qetë hotjanët, në shtator 1879, Porta e Lartë likuidoi

borxhet e prapambetura dhe i caktoi të shpërndanin drithin e dërguar për disa fise edhe në Kelmend, Grudë e Triepsh. Por në janar 1880, kur u vendos në dëm të Hotit për vijën e re të kufirit me Malin e Zi (18 prill 1880 u nënshkrua paqja e Perandorisë Osmane me Malin e Zi në Stamboll) asgjë nuk mund ta ftohte gjakun e malësorëve. Shih: F. Nopça, *Fiset e Malësisë...*, f. 115, 119; *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.II, Tiranë: "Toena", 2002, f. 183-188, etj.

Më 4 mars 1880 fiset e Hotit, Grudës, Kastratit dhe Kelmendit shpallën se do të mbronin me armë viset e lëshuara rishtaz Malit të Zi. Historia më tej është e njohur. Shqiptarët e ndalën me armë aneksimin e Hotit. Sipas Baronit Franc Nopça, valiu i Shkodrës qëndroi pasiv, por komandanti ushtarak i Tuzit, Osman Pasha, i përkrahu malësorët. Vjena e urdhëroi konsullin e vet në Shkodër, Lippih-un të bindte Hotin t'i shtrohej fatit. Më 22 prill Osman Pasha lajmëroi Malin e Zi vetëm 8 orë para tërheqjes së trupave të tij (jo 24 orë) se do të lëshonte Tuzin. Ndërkohë 400 shqiptarë (shumë hotjanë) zunë pozicionet për mbrojtje. Të nesërmen numri arriti në 12.000 vetë. (*Po aty*). Ndër veprimet në vijim të hotjanëve nga kjo kohë deri në vitin 1893 Franc Nopça rendit këtë kalendar:

Në gjysmën e dytë të majit 1880, ndër 6.800 luftëtarë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit të përqendruar në Helm, 500 ishin hotjanë.

Më 1 korrik 1880 po rrezikohej Ulqini. Krerët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për Shkodrën vendosën për të organizuar një sulm kundër Malit të Zi. Hoti e Gruda më 12 korrik pushtuan fshatin Matagosh, por më 23 korrik patën humbje.

Në fillim të gushtit 1880, ndër 1.400 burra të vendosur për mbrojtje midis Helmit e Dinoshit, në Tuz etj., ishin edhe 60 hotjanë.

Kur Porta e Lartë i dorëzoi Ulqinin Malit të Zi, hotjanët reagues. Më 20 nëntor, ato vunë dorë në 600 kasa municion, që Osman Pasha në prill ia la Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Tuz dhe Helm.

Në shtator të vitit 1881 Hoti e Gruda, që ishin me Austro-Hungarinë, deshën të sulmojnë Malin e Zi...

Më 1882 tërë fisi Hot sulmoi për plaçkë në Mal të Zi dhe rrëmbeu në Kuç 612 dhen.

Më 1883, rreth 3000 burra nga Hoti, Gruda e Kastrati u përleshën me forcat osmane në Tuz dhe pranë liqenit. Hafiz Pasha, më 10 qershor, me 4 batalione u fut në Hot dhe rrënoi gjithçka. Kryengritja u shtyp më 25 qershor. Nuk u dorëzuan vetëm bajraktari i Kastratit, Dod Preçi, ai i Grudës Ismail Martini, Ded Gjo Luli nga Hoti dhe disa të tjerë. Por këta nuk u joshën dot nga Mark Milani dhe preferuan të mos shkonin për t'u strehuar në Mal të Zi. Pavarësisht nga rreziku qëndruan në vendin e tyre.

Në shkurt 1884 krerët e Malësisë, që nuk ishin dorëzuar, qëndronin ende të fshehur.

Më 1886 dështoi tentativa e emisarëve malazezë për të nxitur Malësinë e Madhe kundër qeverisë osmane. Duke arrestuar shefin e policisë së Malësisë së Madhe Zenel Beun, valiu i Shkodrës Mustafa Pasha, fitoi simpatinë e banorëve të

Dokumentacioni diplomatik i Fuqive të Mëdha europiane, por edhe i shteteve fqinje, gjithashtu dokumentacioni osman, janë të mbushur me informacion për veprimtarinë e hotjanëve, veçanërisht në vitin 1911. Merita e atyre, që organizuan dhe shpërthyen Kryengritjen e fuqishme të Malësisë së Madhe, qëndron në faktin se, ndryshe nga shumë kryengritje të së kaluarës, ajo nuk synoi realizimin e kërkesave të thjeshta, por realizimin e synimeve që shtroheshin në rrafsh mbarëkombëtar. Bashkëpunimi me intelektualë të shquar të kohës, jo vetëm të qytetit të Shkodrës, por edhe më gjerë, deri te figura të tilla si Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, Risto Siliqi, Nikollë Ivanaj, etj., i dha kësaj kryengritjeje një frymëmarrje të paparë deri atëherë¹. Një varg dokumentesh të rëndësishëm, veçanërisht “Libri i Kuq”, apo Memorandumi i Greçës, akti i ngritjes në majën e Bratiles, në Deçiq, i flamurit kombëtar dhe veprime të tjera, që nuk rreshtën për disa muaj me radhë, shpalosën vizionin e kryengritësve të Malësisë së Madhe, vizionin e hotjanëve në radhët e tyre dhe vizionin e Dedë Gjo Lulit ndër hotjanët². Kërkesat e këtij momenti, që çonin drejt autonomisë dhe sakrifica e jashtëzakonshme për realizimin e tyre, bënë përshtypje të veçantë në kancelaritë e Fuqive të Mëdha. Edhe pse për momentin këto fuqi ishin për *status quo*-në në rajon, përfshirë edhe Perandorinë Austro-Hungareze (e cila i qasej në mënyrën më pozitive çështjes shqiptare) dhe prandaj kishin qenë kundër kryengritjeve shqiptare, që nga vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në raportet dhe

asaj treve. Thuhet se Ded Gjo Luli për këtë simpati pranoi të bashkëpunonte me qeverinë.

Më 1887 propaganda malazeze (Mark Milani) nuk pati sukses në Malësinë e Madhe, madje në gusht e shtator pati përpjekje midis shqiptarëve e malazezëve.

Më 1889 malazezët vranë 2 hotjanë për të marrë gjakun e bajraktarit të Triepshit.

Më 1889 krerët e Malësisë së Madhe, dikur të arratisur dhe tani armiq të Malit të Zi, morën 100 napolona ar nga Austro-Hungaria.

Më 1890 malazezët ndërmorën sulm kundër Hotit por u tërhoqën sepse, nga informacioni i konsullatës austro-hungareze, hotjanët u gjetën të përgatitur.

Më 1892 ndodhi konflikt me Malin e Zi për kullota të Hotit të pushtuara nga Triepshi. Valiu i Shkodrës Abdyl Qerimi, mbajti në këtë rast anën e Malit të Zi.

Konflikti vijoi edhe në vitin 1893. (F.Nopça, *Fiset e Malësisë...*, f. 121-127).

¹ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.II, f. 443.

² *Po aty*; Gjergj Nikprelaj, *Kryengritja e Malësisë e vitit 1911*, Gjonlekaj, Publishing Co., New York, 2004, f. 275-278; Sokol Gjermani, *Kryengritja shqiptare e vitit 1911*, Botimet “Toena”, Tiranë, 2011, f. 234-239, etj.

vlerësimet e të gjitha niveleve të diplomacisë europiane, ndihet vlerësimi dhe jo rrallë admirimi për atë çka bënin shqiptarët³. Ngjarje të mëvonshme do të provonin se aktiviteti i hotjanëve në periudhën e fundit të Rilindjes Kombëtare nuk ishte një veprim momental, por një veprimtari e vazhdueshme, që rridhte nga atdhedashuria dhe dëshira për të realizuar synimet e mëdha kombëtare.

Në kuadër të gjithë veprimtarive patriotike të Malësisë së Madhe, Hoti ka të drejtë të mburret për angazhimin e veçantë dhe sakrificat e veçanta.

*

* *

Le të shohim konkretisht çfarë na ofron për rolin e Hotit dhe hotjanëve në Kryengritjen e Malësisë së Madhe, dokumentacioni european dhe posaçërisht ai austro-hungarez i vitit 1911. Pa dyshim, viti 1911, është momenti i dytë kulmor kur Hoti futet dukshëm, në një mënyrë ose në tjetrën, në optikën e diplomacisë së kohës. Pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kur çështja e viseve të Hotit e të Grudës u trajtua në mënyrë të veçantë nga Kongresi i Berlinit, në kuadrin e diskutimeve për territoret shqiptare, që Perandoria Osmane duhej t'i lëshonte Malit të Zi, me ç'rast ka një dokument të bollshëm, në vitet 1910-1912, Hoti së bashku me Grudën e Kastratin, e më pas Kelmendin, Shalën, Shoshin dhe gjithë Malësinë e Madhe, do të tërhiqnin përsëri vëmendjen e Evropës. Në këtë hark kohor 3-vjeçar, Kryengritja e njohur e vitit 1911 ishte tërësisht ekskluziviteti i Hotit dhe i fiseve të tjera të Malësisë së Madhe. Forca e kësaj kryengritjeje, vendosmëria e kryengritësve, kohëzgjatja 5-mujore e kryengritjes (23 mars - 13 gusht 1911), programi kombëtar i saj, qëndrimi i palëkundur i prijësve të saj, në radhë të parë hotjanit famëmadh, vojvodës së Traboinit, 71-vjeçar Ded Gjo Lulit (1830-1915), përcaktuan interesimin e posaçëm të diplomacisë europiane, për ngjarjet në kufirin veriperëndimor ballkanik të Perandorisë Osmane⁴.

Në dokumentacionin e kohës, european, ballkanik dhe osman, natyrisht informacioni që ekziston për Kryengritjen e Malësisë së Madhe,

³ Arkivi i Institutit të Historisë (më tej: *AIH*), Arkivi i Vjenës (më tej *Vj.*), dosje të vitit 1911.

⁴ Korrespondenca e dëndur diplomatike e kohës pasqyron interesimin e sipërpërmendur (Shih p.sh. dokumente austro-hungareze të mars-gushtit 1911, në *AIH*, *Vj.* dosjet e mars-gushtit 1911).

në përgjithësi, si dhe për Hotin e hotjanët në veçanti, nuk është në të njëjtat përmasa, qoftë në sasi, qoftë në dhënien e detajeve dhe imtësive.

Në informacionin që siguron dokumentacioni osman dhe ai i Malit të Zi, të dhënat janë të shpeshta dhe mjaft të detajuara, shpesh deri në imtësi. Autoritetet osmane të vilajetit të Shkodrës raportnin gjithçka ndodhte në juridiksionin e tyre. Po kështu, autoritetet malazeze të të gjitha niveleve, për shkak të pozitës kufitare të Malit të Zi, me territorin osman ku shtrihet Malësia e Madhe, dhe të interesit të veçantë për këtë trevë të lakmuar, informonin rregullisht për situatën në trevën në fjalë⁵. Prandaj Hoti e hotjanët, si fis i parë i Malësisë së Madhe, gjejnë vend qendror në dokumentacionin e vitit 1911 të këtyre dy shteteve. Në dokumentacionin osman e malazez Hoti, hotjanët e më i shquari ndër ta, Ded Gjo Luli, figurojnë dendur, qysh në gushtin e vitit 1910, kur, nën trysinë e operacioneve ushtarake osmane në Podgoricë mbërritën refugjatët e parë nga Malësia e Madhe. Deri në shtator të vitit 1910 numri i tyre kishte mbërritur në rreth 2.500 vetë, midis gjithsej 15-20.000 shqiptarëve, që u strehuan në Malin e Zi, pas shtypjes së Kryengritjes së Kosovës (1910)⁶.

Informacioni për këtë dyndje ndonëse më i rrumbullakosur, figuron edhe në kancelaritë e Fuqive të Mëdha europiane, në radhë të parë të Austro-Hungarisë dhe të Italisë, që kishin interesa të posaçme në Shqipëri, por edhe të Rosisë, Anglisë, Francës e Gjermanisë, dhe të fqinjëve të afërt, Serbisë, Bullgarisë e Greqisë⁷.

Në informacionet që përpunoheshin në kancelaritë e shteteve të sipërpërmendur figuronin edhe lëvizjet që bënin në dimrin e viteve 1910-1911, personalitete si Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, Nikolla Ivanaj etj.,

⁵ AIH, dokumente mars-gusht 1911; Arkivi Shtetëror i Malit të Zi (më tej ASHMZ), Cetinë, MPJ, dokumente të vitit 1911; Gj.Nikprelaj, *Kryengritja* Shih referimet arkivore e mediatike.

⁶ Romeo Gurakuqi, *Kryengritja e Malësisë së Mbishkodrës 1911*, Phoenix Shkodra, Shkodër 2002, f. 26-30; shih edhe Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1911-1912*, Libri II, Prishtinë: KGT, 2004, f. 15-16; Zekeria Cana, *Politika e Serbisë kundrejt çështjes shqiptare 1903-1913*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë: 2006, f. 83-85 etj.

⁷ AIH, Arkivi i Vjenës, gusht – tetor 1910; shih edhe Gj.Nikprelaj, *Kryengritja* ..., f. 79. Citohet "Cetinjski Vjesnik", nr. 56, dt. 19.07.1911; Gazmend Shpuza, "Kryengritja shqiptare e vitit 1911", në *Buletinin shkencor të Institutit Pedagogjik*, nr. 6, viti 1967, Shkodër 1967, f. 70.

të cilët po përqipeshin për të organizuar një qendër të vetme, brenda ose jashtë Shqipërisë, si edhe veprimtaria e komiteteve të krijuar jashtë territorit të Perandorisë Osmane në shërbim të lëvizjes që pritej të shpërthente më 1911 në Shqipëri. Të dhënat për Komitetin e Podgoricës, të krijuar në shkurt të vitit 1911, dhe veprimtarinë e tij, u relatuan në përmasa të ndryshme nga përfaqësues diplomatikë të Fuqive të Mëdha në Shkodër e Cetinë. Në relacionet për Vjenën dhe Romën, të dhënat shkonin deri në informacionin për degët që u krijuan në Rijekë, Cetinë, Virpazar, Tivar e Kotorr, ose për personalitetet që u përfshinë në veprimtarinë e Komitetit si Luigj Gurakuqi, Mark Kakarriqi, Risto Siliqi, Ismail Qemali, Pandeli Cale, Nikollë Ivanaj, Hilë Mosi etj.⁸

Shenjat për shpërthimin e Kryengritjes së vitit 1911, kancelaritë e Fuqive të Mëdha i kishin identifikuar qysh në muajt e parë të atij viti. Ambasadori i Austro-Hungarisë në Stamboll, në shkurt 1911, i relatonte qendrës së I.Qemali në një takim me të, i kishte bërë të qartë shpërthimin e afërt të kryengritjes, për shkak të pakënaqësisë së shqiptarëve nga politika e xhonturqve. Diplomati austro-hungarez në Cetinë, gjithashtu, raportonte më 5 mars se priteshin të ndodhnin luftime të ashpra në kufirin shqiptaro-malazez⁹. Raporte të ngjashme ato ditë i shkonin Vjenës edhe nga Vlora, Durrësi, Trieste etj. Në to ka të dhëna edhe për përpjekjet e shqiptarëve për të siguruar armë për kryengritjen. Masar Toptani ishte ndër të identifikuarit që vepronin për të blerë armë në Evropë¹⁰. Sir G. Lawther i shkruante Foreign Office-t më 31 janar 1911, se ekspedita e Turgut Pashës në Shqipëri, më 1910, kishte acaruar në kulm shqiptarët, kurse politika e mobilizimit ushtarak, që nuk merrte në konsideratë faktin nëse meshkujt e kishin kaluar ose jo moshën e kryerjes së shërbimit aktiv

⁸ *AIH*, Arkivi i Vjenës, dosje të periudhës shkurt-mars 1911; shih edhe Qamil Gexha, *Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze*, Gjakovë: Blini BK, 2003, f. 189; Gazmend Shpuza, *Në vazhden e gjurmëve për Epokën e Rilindjes Kombëtare*, Tiranë: "Toena", 1997, f. 205; S. Gjermëni, *Kryengritja ...*, f. 15-16 etj.

⁹ *AIH*, Arkivi i Vjenës, Vj. 21-3-354; shih edhe Stavro Skëndi, *Zgjimi Kombëtar Shqiptar (1878-1912)*, Phoenix SHLAK, Tiranë 2000, f. 372.

¹⁰ *AIH*, Arkivi i Vjenës, Dokumente të janar – marsit 1911; *AIH*, H-22, Raport i legatës bullgare nga Roma, nr.50, dt. 29 janar (11 shkurt) 1911, dërguar MP të Jashtme në Sofje, me informacion rreth përpjekjeve të N.Ivanajt për të siguruar mbështetjen e qarqeve të caktuara qeveritare e opozitare në Itali, si edhe të Riccioto Garibaldit për të mbështetur me vullnetarë dhe me armë kryengritjen shqiptare; shih edhe R.Abdyli, *Lëvizja Kombëtare ...*, f. 27-28; etj.

ushtarak dhe mbledhja e tatimeve me dhunë, e kishte bërë të pashmangshëm ndezjen e zjarrit kryengritës nga fiset malore gjysmë të lira, që nuk kishin dorëzuar kurrë armët, nuk kishin shkuar ushtarë e nuk kishin paguar rregullisht taksa.¹¹ Por një arsye e përgatitjes së konfliktit dhe shtimit të të larguarve nga Hoti dhe viset e tjera të Malësisë së Madhe drejt Malit të Zi, sipas një vëzhgueseje të hollë si Edith Durham, që natyrisht e çonte informacionin për konstatimin e saj në Londër, ishte edhe politika joshëse e Nikollës së Malit të Zi, që u premtonte malësorëve strehë, mbrojtje, armë e deri “pavarësi të plotë”, po të ngriheshin kundër “turkut”, ndërkohë që planifikonte që Malësinë e Shkodrës t’ia bashkonte Malit të Zi¹².

Pothuaj në të gjithë kryeqytetet e shteteve europiane të interesuar për zhvillimet në kufirin osmano-malazez, mbi bazën e raporteve të diplomatëve të akredituar në vilajetet shqiptare, si edhe në Malin e Zi dhe në Stamboll, nuk mungon informacioni se Kryengritja e malësorëve të Malësisë së Madhe shpërtheu para kohe, për shkak të presionit të autoriteteve malazeze mbi Komitetin e Podgoricës dhe krerët shqiptarë në arrati. Nuk kemi mundur të gjejmë të dhëna autentike dokumentare, por në literaturën historike të konsultuar, në kuvendin që malësorët mbajtën në mars 1911, në fshatin Vrellë, në verilindje të Podgoricës, ku morën pjesë edhe ministrat malazezë, Ded Gjo Luli, kishte bërë një deklaratë të fortë. Vojvoda i Traboinit, figura numër një ndër malësorët e strehuar në Malin e Zi, kur dëgjoji prononcimin e hapur të krajl Nikollës, se në viset e çliruara nga osmanët do të ngrinte flamurin malazez, duke folur në emër të të gjithë prijësve dhe luftëtarëve të Hotit dhe fiseve të tjera të Malësisë, kish theksuar se shqiptarët “*kanë derdhur gjakun e tyre, jo që të përfitojë Mali i Zi ... Ne, nuk kish nguruar të kërcënonte atdhetari i shquar, jemi gati të rrokim armët edhe kundër jush nëse cenoni trojet e tagrat tona...*”¹³.

Në dokumentacionin e kohës përmendet ndërprerja më 14 mars e ndihmës për malësorët e strehuar në Malin e Zi prej autoriteteve të Cetinës, çka përcaktoi shpërthimin e parakohshëm të kryengritjes. Që malësorët nuk kishin ndër mend të bindeshin, konfirmohet indirekt nga

¹¹ *Po aty*, Dokumente të zgjedhura 1864-1913, Raport i G.Lowther, dt. 31.I.1912; shih edhe S. Gjermëni, *Kryengritja...*, f. 19.

¹² Edit Durham, *20 vjet ngatërresa ballkanike*, Tiranë: Argeta LMG, 2001, f. 230; *AIH*, H-22, Raport i legatës bullgare në Cetinë, nr. 393, dt. 19 dhjetor 1910 (11 janar 1911), për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Sofje.

¹³ Pal Doçi, *Ded Gjo Luli*, Botimi i III, Tiranë: Geer, 2003, f. 60.

një raport i konsullit austro-hungarez në Shkodër, Zambaur, dërguar më 17 mars, Ministrisë së Jashtme në Vjenë. Sipas konsullit një komision osman kishte arritur në Shkodër për të inspektuar fortifikatat në kufirin me Malin e Zi dhe për të propozuar fortifikime të reja në Hot, mbi malin e Taraboshit, në Bushat, Pulaj e Shëngjin.¹⁴

I njëjti konsull më 27 mars njoftonte ambasadorin austro-hungarez në Stamboll (Muller), se më 24 mars “vojvoda i Traboinit, Ded Gjo Luli, me 15-20 vetë, shumica hotjanë, sulmoi kullën (postën ushtarake) pranë Rapshës së Hotit, kurse në mbrëmjen e ditës tjetër (25 mars), bashkë me 200-300 kelmendas sulmoi dhe pushtoi kullën e Grabonit, që kontrollonte rrugën për në Selcë. Konsulli nuk lë pa përmendur veprimin njerëzor të Ded Gjo Lulit, që, pasi i kishte çarmatosur i kishte lënë të lirë ushtarët osmanë.¹⁵

Lajmi rreth sulmit të hotjanëve, më 24 mars, nën drejtimin e Ded Gjo Lulit, me sa duket kishte bërë xhiron e botës, dhe ishte lajm i ditës në të gjithë kancelaritë e mëdha. Konti Berchtold, (ministri i Jashtëm i Austro-Hungarisë një vit më vonë) ambasadori i Austro-Hungarisë në Petrograd, njoftonte Vjenën më 30 mars se ai kish mësuar prej autoriteteve të vendit (prej zotit Neratov) mbi sulmin e malësorëve dhe suksesin e tyre në asgjësimin e disa fortifikatave osmane¹⁶.

Në dijëni të plotë ishte edhe Londra. I njoftuar me sa duket edhe nga vetë ambasadori osman në Britaninë e Madhe për sukseset e para të kryengritësve, që brenda 3 ditësh kishin marrë postet në Stare të Hotit e në Pikale e Salishte të Grudës, e disa pozicione në Deçiq, prej nga dominohej fusha e Tuzit, nënsekretari britanik i Shtetit, sër Nikolson, ishte shprehur se kryengritja që kishte shpërthyer në Shqipëri dukej mjaft e përgjithshme. Ambasadori i Austro-Hungarisë në Londër informonte eprorët në Vjenë se ambasadori osman në Londër kishte tentuar pa sukses

¹⁴ *AIH*, Vj. 21-9-978, Raport i konsullit austro-hungarez në Shkodër, Zambaur, për eprorët në Vjenë, dt. 17 mars 1911; shih edhe R.Abdyli, *Lëvizja kombëtare...*, f. 32; Sh.Rrahimi, *Lufta e shqiptarëve për autonomi 1897-1912*, Rilindja, Prishtinë 1978, f. 175 etj.

¹⁵ *Po aty*, Vj. 21-12-1225, Telegram i konsullit Zambaur i 27 marsit 1911, për ambasadorin e Austro-Hungarisë në Stamboll, Muller; shih edhe R.Gurakuqi, *Kryengritja ...*, f. 74; R.Abdyli, *Lëvizja kombëtare...*, f. 34-36; etj.

¹⁶ *Po aty*, Vj. 21.9.944, Telegram e Berchtoldit për Ministrinë e Jashtme në Vjenë, dt. 24 mars 1911.

të siguronte ndërhyrjen e Britanisë në Cetinë që Mali i Zi të mos ndihmonte kryengritësit¹⁷.

Në kancelaritë e Fuqive të Mëdha gjithashtu ishte bërë i njohur lajmi se, për të përballuar sulmin e hotjanëve dhe fiseve të tjera që iu bashkuan atyre, autoritetet osmane, ndonëse e dinin se në Malin e Zi ishin strehuar jo vetëm shqiptarë katolikë por edhe myslimanë¹⁸, po përpiqeshin të nxitnin dasitë fetare dhe, në këtë kuadër, po u shpërndanin armë myslimanëve të Shkodrës¹⁹.

Lajmet ishin përhapur gjerësisht edhe në vendet ballkanike, përmes sistemit zinxhir të shkëmbimit të informacioneve midis diplomatëve të akredituar. Në Selanik autoritetet vendore dhe të gjithë konsullatat më 31 mars e dinin se hotjanët kishin sulmuar postat (karakollat) e osmanëve më 24 mars dhe deri më 28 mars, pra, për pak ditë, 4000 malësorë katolikë kryengritës kishin pushtuar 10 karakolle kufitare dhe kishin vrarë e kapur rob dhjetëra ushtarë osmanë.²⁰ Ndër karakollat e asgjësuar numëroheshin ato të Traboinit, Humit, Dinoshit, Omaboshit, Pikalës, Selishtit etj.²¹ Diplomatët në Cetinë dinin gjithashtu se ushtria osmane u përpoq të kundërveprojë. Ndër të tjera, repartet e saj, sikurse u bë e njohur në Cetinë, dolën në Drum të Hotit duke djegur për hakmarrje 20 shtëpi të kryengritësve.²²

Por pak më vonë u përhapën lajmet se më 30 mars kishte rënë në duart e kryengritësve edhe Tuzi. Informatat për sukseset e shpejta të kryengritësve hotjanë të 24 marsit e pastaj të 4000 malësorëve kryengritës edhe nga Gruda, Kastrati, Kelmendi, Salca, Shkreli, Shala etj., në ditët në vijim, të cilat kishin marrë dhenë në ditët e para të prillit, vunë në lëvizje diplomacinë e Fuqive të Mëdha, dhe njëherësh edhe monarkitë e vogla të Ballkanit.

¹⁷ *Po aty*, Vj.21.9.946, Raport i ambasadorit austro-hungarez në Londër, Mensdorff për eprorët në Vjenë, 31.3.1911,

¹⁸ *Po aty*, Vj. 21.3.349, Raport i konsullit austro-hungarez në Shkodër, Zambaur, dt. 27.03.1911, për Vjenën.

¹⁹ *Po aty*, Vj. 21.9.944, Telegram i nisur nga Vjena, dt. 30.03.1911.

²⁰ *Po aty*, Vj. 21.14.1482. Tel. i konsullit austro-hungarez, Para, nga Selaniku për Vjenën, 31.III.1911.

²¹ R. Abdyli, *Lëvizja kombëtare ...*, f. 34.

²² *Leka*, numër përkujtimor, 1937, f. 370; shih edhe R. Abdyli, *Lëvizja kombëtare ...*, f. 35.

Më 1 prill 1911, figura e diplomacisë ruse Neratov kish kontaktuar e biseduar rreth ngjarjeve në kufirin osmano-malazez me ambasadorin austro-hungarez dhe sigurisht edhe me ambasadorët e tjerë²³. Në të njëjtën ditë ministri austro-hungarez në Athinë, informonte se ngjarjet në Shqipëri ndiqeshin me vëmendje të madhe nga qeveria greke²⁴.

Zambaur, konsulli i Austro-Hungarisë në Shkodër, ndërkohë njoftonte Ballplatzin se për Shefqet Turgut Pashën, gjeneralin osman të dërguar për të shtypur kryengritjen, shkaktarët apo krerët e kryengritjes ishin Ded Gjo Luli nga Hoti e gjithashtu Luc Mark Gjeloshi, Marash Pali, Frano Pali nga Salca; Marash Luci nga Kastrati; Sokol Baci nga Gruda, Tom Nika nga Shkreli dhe Mehmet Shpendi nga Shala.²⁵

Për luftimet e ditëve të para të prillit në vijën Dinosh-Deçiq, që gjithashtu pasqyrohen në raportet diplomatike të kohës, burrat e tij do të përmendeshin sërish. Në kanalet diplomatike relatohej se në vijën e sipërpërmendur të luftimeve, ndër forcat kryengritëse prej rreth 2200 burrash, bënin pjesë 400 hotjanë (900 nga Gruda, 600 nga Kelmendi, 250 nga Shala dhe një numër i vogël nga Shkreli)²⁶.

Ndërkohë kancelaritë e Fuqive të Mëdha ishin informuar për një hap tjetër të rëndësishëm të kryengritësve. Në një mbledhje në Cetinë, më 30 mars, krerët e tyre, ndër të cilët Ded Gjo Luli (të tjerët ishin Muharrem Bushati, Isa Boletini, Sokol Baci) hartuan një memorandum të cilin ua dorëzuan ministrave të Fuqive të Mëdha të akredituar në kryeqytetin e Malit të Zi.²⁷ Në këtë program politik të paraqitur 6 ditë pas fillimit të kryengritjes kërkoheshin që vilajetet shqiptare të drejtoheshin nga guvernatorë shqiptarë, të njihej këmbësia shqiptare, të njihej shqipja si gjuhë zyrtare në katër vilajetet dhe gjuhë mësimi në shkollat, shkollat shqipe të subvencionoheshin nga qeveria, të ardhurat e vendit të përdorreshin për nevojat e tij dhe shërbimi ushtarak të kryhej brenda vendit në kohë paqeje. Përmes këtij memorandumimi krerët e kryengritjes

²³ *AIH*, Vj. 21.3.321, Petersburg, 1.IV.1911, Raport i ambasadorit austro-hungarez, Thurn.

²⁴ *Po aty*, Vj. 21-3-220, Telegram dt.1.IV.1911, i ministrit austro-hungarez të akredituar në Athinë për Vjenën.

²⁵ *Po aty*, Vj. 21.12.1229, Raport i Zambaur nga Shkodra, 11.04.1911, për Vjenën.

²⁶ *Po aty*.

²⁷ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, f. 445; S.Gjermëni, *Kryengritja ...*, f. 29.

së Malësisë së Madhe bënë të ditur se luftonin jo për kërkesa lokale por të rrafshit kombëtar.²⁸

Dokumentacioni diplomatik i kohës ka pasqyruar edhe zhvillimin e mëtejshëm të ngjarjeve në Malësinë e Madhe gjatë prillit të vitit 1911. Aty pasqyrohen luftimet ofensive të trupave osmane në ditët e para të prillit, depërtimi i tyre në Hot e Kastrat (u dogjën Vuksan Lekaj, u ripushtua Humi dhe Deçiçi, Tuzi etj.)²⁹, por edhe kundërpërgjigja e vendasve. Lajmi se kryengritësit e Hotit ishin përleshur me trupat osmane në Helm dhe u kishin shkaktuar humbje të konsiderueshme (25 të vrarë, po kaq të plagosur dhe rreth 20 robër), ishte marrë nga të gjithë, kancelaritë e fuqive të interesuara evropiane, madje ai qarkullonte edhe në nivelin e përfaqësive konsullore të nivelit të zakonshëm³⁰. Në një telegram e më pas në një raport më të detajuar, të 12 prillit, konsulli i Austro-Hungarisë në Selanik, Gregoviç, ia njoftonte këtë lajm ambasadorit të vet Muller në Stamboll. Po në të njëjtën ditë Mulleri, nga Stambolli i kishte raportuar Vjenës të njëjtin lajm, duke theksuar zhvillimet e ngjarjeve në trevën e Hotit dhe në qytezën e Tuzit.³¹

Po kështu qarkullonte edhe informacioni për luftimet e 6 prillit pranë Deçiqit, për humbjet e osmanëve aty (30 ushtarë), por edhe të kryengritësve (7 vetë), ndër të cilët ishte vrarë edhe flamurmbajtësi Nish Gjelosh Luli; gjithashtu dhe lajmi se më 6 prill kryengritësit kishin ngritur flamurin kombëtar në majën e Bratilës së Deçiqit³². Meritë për aktin e rëndësishëm kishte Ded Gjo Luli, të cilit tradita gojore i atribuon edhe fjalë të shkurtëra mbresëlënëse ... “Tash o vllazën do t’ju takojë të shihni atë që për 450 vjet se ka pa kush...”³³.

²⁸ Po aty; shih edhe *AIH*, Nikolla Vllahu, *Istoria ton kraton tis Valkanikis Hersonisu 1908-1914*, Athinë 1954, f. 7.

²⁹ R. Gurakuqi, *Kryengritja ...*, f. 83-84; P. Doçi, *Dedë Gjo Luli ...*, f. 75; R. Abdyli, *Lëvizja kombëtare...*, f. 46.

³⁰ Централен Државен Исторически Архив (më tej: ЦДИА), Sofia, F. 395, on. 1, ae 441, Извештаи на царска лечаница ад Цетина у битола, Nr. 408, dt. 4 (17) gusht 1911.

³¹ *AIH*, Vj. 21.14.1487, Selanik, 12 prill 1911, Vj. 21.7.227, Stamboll, 12 prill 1911, Telegram i Gregoriçit dhe raport i Mullerit, Vj. 21.7.730, Selanik, 12 prill 1911, Raport i Gregoriçit.

³² R. Abdyli, *Lëvizja Kombëtare...*, f. 48; S. Gjermëni, *Kryengritja ...*, f. 31 etj.

³³ P. Doçi, *Dedë Gjo Luli...*, f. 84.

Në dokumentacionin e kohës, për luftimet e 7-8 prillit sulmi i hotjanëve dhe grudasve në Dinosh, rezultoi me rimarrjen e pozicioneve të humbura në ditët e para të prillit³⁴, kurse deri më 13 prill në saje të një angazhimi më të madh të burrave të Kelmendit, Shalës e Shkrelit, krahas fiseve të Hotit, Grudës e Kastratit, ishin fituar disa pozicione strategjike në Deçiq dhe në afërsi të Tuzit³⁵. Këto luftime i pasqyronte edhe informacioni telegrafik që atashu ushtarak i Austro-Hungarisë në Stamboll i dërgonte më 20 prill Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë perandorake në Vjenë. Ai theksonte se malësorët kishin sulmuar Tuzin dhe kodrat në Lindje të tij, të quajtura “Mali i Hotit”³⁶.

Në dokumentacionin e mesit të muajit prill figuron edhe njoftimi për një peticion, që 9 krerët më të rëndësishëm të kryengritjes (Hotit, Grudës, Kastratit dhe Shkrelit), me të parë Ded Gjo Lulin, i kishin dërguar sulltan Mehmet Reshatit V, në Stamboll. Telegrami i konsullit austro-hungarez në Podgoricë, kishte edhe përmbajtjen e peticionit³⁷. Por në kancelaritë e Fuqive të Mëdha, të shteteve të Ballkanit, dhe në qendrën e Perandorisë Osmane, mbërrinin edhe lajme se ndihma e Malit të Zi për mijëra malësorë të strehuar atje, ishte e pamjaftueshme dhe rezistenca këmbëngulëse e tyre dukej një çudi po të llogariteshin kushtet e tyre të vështira. Në një letër të dërguar nga Podgorica, që mban datën 21 prill 1911, peshkopi i Grudës, Bonaventura Gjeçaj, i kërkonte njeriut të afërt me qarqet e larta të Vjenës, dr. Pekmezit, të përpiqej të siguronte ndihma për popullsinë e Hotit, Grudës, Kastratit dhe Selcës, që po luftonte duke vuajtur nga mungesa e bukës³⁸.

Bota ndërkohë ishte informuar për përgatitjen e një ofensive të re osmane. Kryekomandantit të ushtrisë osmane, të dërguar për shtypjen e kryengritjes, Shefqet Turgut Pashës, i kishin mbërritur në përforcim 8 batalione me 5.000 ushtarë, dy bateri malore një repart mitralier, 800 kuaj dhe 10.000 pushkë e materiale të tjera lufte, që më 17 prill ishin zbarkuar

³⁴ R.Abdyli, *Lëvizja Kombëtare...*, f. 47; ЦДИА, f. 395, on 1, ae 441. Njoftim i legatës mbretërore bullgare në Cetinjë, bp.408, 04 (17) 08.1911.

³⁵ R.Abdyli, *Lëvizja Kombëtare...*, f. 49-50; S. Gjermëni, *Kryengritja ...*, f. 33.

³⁶ *AIH*, Vj. 21.7.773, Stamboll, 20 prill 1911, Telegram i atashut ushtarak të Austro-Hungarisë.

³⁷ *Po aty*, Vj. 21.15.1509, Podgoricë 14.IV.1911. Telegram i konsullit austro-hungarez në Podgoricë për eprorët.

³⁸ *Po aty*, Vj. 21.7.1742, Podgoricë, 21 prill 1911, Letër e B.Gjeçajt për dr.Pekmezin.

në Shëngjin. Përballë tyre mbeteshin gjithnjë 3-4000 malësorë kryengritës, ndër të cilët gati të gjithë burrat e pushkës së Hotit, me në krye Ded Gjo Lulin, që do të përballonin në vijën e parë ofensivën e re³⁹. Veprimet e egra të trupave osmane në dy javët e fundit të prillit, gjithashtu kishin kaluar si lajm në linjat e diplomacisë, deri në ato detaje për të cilat evropianët ishin të ndjeshëm. Në një raport të konsullit austro-hungarez nga Shkodra, të dt. 24 prill, dërguar eprorëve, flitet për incidente në territorin e Hotit, në Rapshë e Trabonjë, si edhe në Shosh, por theksohet se kishat dhe famullitë nuk ishin dëmtuar⁴⁰. I njëjti diplomat raportonte më 2 maj se në Hot, Grudë e Kastrat kryengritësit ishin aktivë dhe se 1000 shaljanë, shoshas e merturas, kishin arritur në Podgoricë për t'u pajisur me armë⁴¹. Por qarkullonin lajme edhe për kërcënime të egra të Shefqet Turgut Pashës ndaj kryengritësve.⁴²

Njoftime të ngjarjeve më me jehonë, deklarata për Shqipërinë, pavarësinë dhe shpalljen e qeverisë së përkohshme, mandej publikimi në gazetën austriake "Vaterland", më 1 maj, i thirrjes që Komiteti Qendror Shqiptar në Podgoricë i drejtoi në shqip, frëngjisht, gjermanisht dhe italisht, qeverisë së Turqve të Rinj dhe opinionit publik, duke kërkuar autonomi (nën garancinë e Fuqive të Mëdha), të cilat bëheshin të njohura në të gjitha kancelaritë evropiane nuk sfumoin lajmet për ngjarjet nga terreni i luftimeve⁴³. Në vijim të njoftimeve për qëndresën e fortë të malësorëve në afërsi të Tuzit dhe në Traboin, Pejnik etj., pasonin ato për amnistinë e premtuar më 11 maj nga Shefqet Turgut Pasha. Komandanti osman, që nga Shkodra, u kish premtuar malësorëve se ishin të falur nëse ktheheshin në shtëpi dhe dorëzonin armët, me përjashtim të tetë krerëve, që do të përballeshin me gjyqin ushtarak. Ndër ta figuronte natyrisht

³⁹ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, f. 446; Peter Bartl, *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)*, Tiranë: "Dituria", 2006, f. 215; S. Gjermëni, *Kryengritja ...*, f. 35.

⁴⁰ *AIH*, Vj. 21.7.711, Telegram nga Shkodra i konsullit Zambaur për eprorët në Vjenë, dt. 24 prill 1911.

⁴¹ *Po aty*, Vj. 21.4.412, Shkodër, 2 maj 1911. Telegram i Zambaur për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë.

⁴² *У этниски бижесник*, бр. 38, Цетинье, 17 (30).05.1911. Побуна Арбанаса, 3.

⁴³ S. Gjermëni, *Kryengritja ...*, f. 37-38; Citohet "Zgjimi i Shqipërisë", Moti II, 2 maj 1911, Janinë, nr. 111.

nismëtari i kryengritjes, vojvoda i Traboinit dhe emri i parë i Hotit, Ded Gjo Luli⁴⁴.

Kryengritësit u kundërpërgjigjën me një deklaratë të miratuar në një mbledhje të mbajtur në Pikalë, të cilën përmes ministrit britanik të akredituar në Cetinë, e siguruan edhe të gjithë diplomatët e fuqive të tjera.⁴⁵ Në deklaratën në fjalë kryengritësit theksonin se për shkak të veprimeve të qeverisë (djegie, rrënime, dhunime, grabitje të sendeve të shtrenjta, etj.) ata do të luftonin deri në pikën e fundit të gjakut. Një ditë para skadimit të afatit të paralajmëruar më 14 maj pashai osman filloi sulmin me 10.000 ushtarë në vijën midis Deçiqit, Tuzit dhe Dinoshës. Përballë tij, raportonin diplomatët e gjendur në Shkodër e Cetinë, ishin rreshtuar 2.000 kryengritës të Hotit, Grudës dhe Kastratit.⁴⁶ Ushtria me këtë rast nuk kurseu as banorë myslimanë dhe bombardoi kishën katolike të Traboinit. Përballë dhunës së egër një numër i madh familjesh nga Hoti e Gruda, morën arratinë.⁴⁷

Rezistenca e paparë e kryengritësve, edhe pse qysh në fund të majit ishin rrethuar nga ushtria, e detyroi Portën e Lartë të shpallte amnisti të përgjithshme më 12 qershor 1911.⁴⁸ Oferta osmane, gjithsesi, nuk i ndaloi hotjanët, të mbështetur edhe nga luftëtarë të fiseve përreth, deri ata të Shalës e Shoshit, të sulmonin forcat osmane më 18 qershor në rajonin e Traboinit dhe më 22 qershor përsëri midis Rapshës e Traboinit⁴⁹. Raportet diplomatike informonin për të gjitha këto, madje edhe për entuziazmin që vendosmëria e malësorëve kishte ngjallur në botë. Njoftime të ndryshme bënë fjalë për gatishmërinë e vullnetarëve të shumtë në Itali e në vende të tjera për të luftuar përkrah kryengritësve. Edhe pse koniunkturat politike penguan, vetëm në linjën e një fushate të

⁴⁴ S.Gjermëni, *Kryengritja ...*, f. 39.

⁴⁵ *Public Record Office - London, (PRO) Foreign Office (FO) 371/1229*, Miss Durham – Spens, Podgorica, 26.05.1911; *Po aty*, Lamb – Sër F. Laster, Saloniki, 28.05.1911; *AQSH*, Shpallje e Shefqet Turgut Pashës, prill 1911 (përkthimi shqip); *AIH*, Vj. 21-7-773, Telegram i atasheut ushtarak austro-hungarez në Stamboll, dt. 27 prill 1911; Shih edhe *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll.II, f. 447, etj.

⁴⁶ *AIH*, Vj. 21.12.1242, Shkodër 20 maj 1911, Raport i Zambaur për ambasadorin Muller.

⁴⁷ *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll.II, f. 448.

⁴⁸ S. Skëndi, *Zgjidhimi Kombëtar Shqiptar...*, f. 375; Shih edhe S. Gjermëni, *Kryengritja ...*, f. 43-44.

⁴⁹ AM.MФ 873, Узбештај српског краљевског конзула из Скопла, 8 (21) 06.1911, МУД Београд; Shih edhe R.Abdyli, *Lëvizja Kombëtare...*, f. 80-81 etj.

kryesuar nga Riçoti Garibaldi, ishin regjistruar të merrnin pjesë përkrah malësorëve rreth 15.000 vullnetarë garibaldinë.⁵⁰ Kurse nga një letër e Gjergj Pekmezit mësojmë se ishte bërë i njohur lajmi se milioneri amerikan Carl R. Krein i kish dorëzuar Edith Durhamit 500.000 franga për të ndihmuar kryengritësit.⁵¹

Kuvendi i Gerçës (apo Greçës), i 23 qershorit 1911, është shumë i njohur. Për të dhe për memorandumun e dalë prej tij, informacionet diplomatike ishin shumë të plota. Nëse kishte patur njoftime për shumëçka më parë, tani vëmendja e jashtëzakonshme e kancelarive evropiane justifikohet plotësisht me rëndësinë, që kishte mbledhja dhe memorandumun në fjalë, si dokumenti më i rëndësishëm i kryengritjes që shpaloste kërkesat jo thjesht të Malësisë së Madhe, por të gjithë shqiptarëve. Europa mësoi se krerët e kryengritjes, ndër të cilët figura e parë e saj Ded Gjo Luli, firmëtarë të memorandumit, ishin në unison të plotë me personalitete politike e publike të dorës së parë në botën shqiptare e më gjerë si Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, Risto Siliqi, etj., etj. Duke vlerësuar rëndësinë e momentit ata ishin mbledhur në Malin e Zi (I.Qemali shkoi në Cetinë për t'u takuar me krerët e malësorëve që në fillim të qershorit 1911) për të projektuar perspektivën mbarëshqiptare dhe prandaj Memorandumun i Greçës, apo "Libri i Kuq", ishte akti që përgjithësonte kërkesat e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare të kohës.⁵² Në korrespondencën midis Londrës dhe Vjenës për këtë çështje, në kabinetin e Erentalit, ministrit të Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, figuronte një telegram i ambasadës britanike në Vjenë, që informonte për kërkesat e krerëve kryengritës, të cilat asaj i ishin bërë të ditura, veçanërisht për kërkesat të cilat kishin të bënin me autonominë e viseve shqiptare, si edhe me mendimet që kreu i diplomacisë britanike, lordi Eduard Grei, kishte për këtë çështje.⁵³ Me sa duket në Londër e kishin studiuar Memorandumun e Greçës, që e kishin marrë përmes diplomatit të tyre në Cetinë, kur përfaqësuesit apo delegacioni i kryengritësve i përbërë nga L.Gurakuqi, Ded Gjo Luli, Sokol Baci etj., përveç Sadedin Beut, ministrit të Perandorisë Osmane të akredituar në Cetinë, kishte marrë takim dhe ua

⁵⁰ *AIH*, Vj. 21.14.1457, Vlorë 11 maj 1911, Raport i konsullit Kraus.

⁵¹ *Po aty*, Vj. 21.8.813, 16 qershor 1911.

⁵² *Po aty*, Vj.21.15.1522, Për përmbajtjen e memorandumit, përveç botimeve monografike dokumentare, shih edhe dokumentet e depozituara në MPJ të A-H në Vjenë.

⁵³ *Po aty*, Vj. 21.15-1523.

kish dorëzuar memorandumimin edhe diplomatëve të Fuqive të Mëdha në Malin e Zi.⁵⁴

Kur bëhej fjalë pra për këtë moment madhor, përkatësisht për shpalosjen e programit politik të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, me kërkesa kryesore sigurimin e autonomisë për gjithë viset shqiptare, hotjanët, përmes Dedë Gjo Lulit, pasi kishin luftuar heroikisht, pasi kishin sakrifikuar ekstremisht, paraqiteshin kështu denjësisht edhe në aspektin politik. Deri më 2 gusht, kur u arrit akordimi midis autoriteteve osmane dhe malësorëve dhe përfundoi kryengritja, hotjanët e përfaqësuar nga Ded Gjo Luli, përmenden nga relacionet diplomatike, si pjesëmarrës në takimet që u zhvilluan në Podgoricë, midis 4 dhe 16 korrikut, ndërmjet parisë së malësorëve dhe arqipeshkvit të Shkodrës, imzot Jak Serreqit, i cili ishte dërguar nga xhonturqit si ndërmjetës në marrëveshje me malësorët.⁵⁵ Me këtë rast ata kishin këmbëngulur për zbatimin e 12 pikave të Memorandumit të Greçës, madje kishin “paraqitur (siç shkruante J. Serreqi) pretendime të drejta mbi territorin e Malësisë, duke përmendur faktin se qeveria e Konstandinopojës (Stambollit), ia kishte lëshuar atë Malit të Zi, me Traktatin e Berlinit, por ata me armë në dorë dhe me gjakun e tyre, nuk kishin lejuar që të pushtohet”⁵⁶.

⁵⁴ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, f. 451; shih edhe S. Gjermëni, *Kryengritja ...*, f. 48; etj.

⁵⁵ *AIH*, Vj. 21-20-2031, Raport i misionit të imzot Serreqit, Gjergj Fishtës dhe Luigj Bumçit, paraqitur valiut të Shkodrës, më 24 korrik 1911.

⁵⁶ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II; R. Abdyli, *Lëvizja Kombëtare ...*, f.101; R. Gurakuqi, *Kryengritja ...*, f. 137; S. Gjermëni, *Kryengritja...*, f. 51; Në kujtimet e Luigj Bumçit të shkruara vite më vonë, *AQSh*, F. 841, D. 157, fl. 47, ai e tregon kështu këtë ngjarje:

“Kahe gjysa e mojit të qershorit 1911, Valija i Shkodrës i atëhershëm z. Mustafa Nedin ju lut Argjipeshkvit të Shkodrës. Shk. së Tij Emzot Serreqit, me shkue në Podgoricë, me u pjekë me Hot e me Grudë qi kishin kalue kufinin e dale në Mal të Zi në kohën e Turgut Pashës, me ju thane atyne që Mreti i kishte falë, por të ktheheshin ndër banime të veta e damet qi kan pasë, kishte me ua u shpërblye.

Edhe Argjipeshkvi mori me vedi At Gjergj Fishtën e mue, e u nismë për Podgoricë.

Mas pak kohe që mërrimë atje, Arqipeshkvi më çoj mue në Trjepshë me u ndeshë me Malsorë që gjindeshin atje, e me ja u diftue mesazhin e Mretit.

Z. D. Nikoll Ashta e At Mati Prenushi me shqënuene n’at udhtëim, e një të Dielë, në nadje herët fort, u gjetmë te Kisha e Trjepshit. Si u mlodhnë malsoret dola e si u përshndeta me ta u thanë kto fjalë: Z. Arqipeshkvi ka dale në Podgoricë me u

pa me ju, por, masi aj vetë nuk mujti me ardhë deri këtu, na ka çue ne. Ju falet pra me shndet e ju çon bekimin.

Të gjithë një gojet u përgjegjën: Zoti i ngjatë jetën Arqipeshkvi e i falena ndërës fort qi na ka kujtue.

Mas këtyne fjalvet u thaçë shka vijon: Arqipeshkvi ma ka ngarkue me ju thane edhe se Mreti ju ka falë, veçse ju thret me këthye ndër shpija të tuaja e ju ep fjalën se ka me ju shpërblye gjithë damet qi keni pasë.

Ju lutne Marash Uçit me folë për të tanë, e Marashi muër fjalën e tha: Zotni po na thue se Mreti na ka falë. Shka me na falë? Na mos i kjosim falë aspak Mretit qyshëse aj në Kuvend të Berlinit na pat lëshue doret e na pat dhanë Malit të Zi. Gjithkush e di kangën “Hot e Grudë na i ka dale fjala – Ja ka falë Mreti Nikollës”. Na qyshë at here nuk kena pa ditë të mire. Vendet tona i kena ruejtë na vetë e s’asht shprep e gur qi nuk e kena la me gjak. Shka don me na falë pra Mreti? Por se jena të vegjël, se me shty pleqni me Mretin, na Mretin kishim me e qitë borxh.

I thamë, si do qi kan kenë ato punët e atëhershme, a doni me këthue ndër vende të tua a jo? Na përgjigjenë se sot për sot nuk kena at mendje.

Edhe na këthueme në Podgoricë e përgjegjen e Malsorve ja prueme Z. Argjipeshkvi. Mas pak kohe (dy a tri dit) po vjen në Podgoricë Ministri i Turkis i Cetinës. Z. Sadedin Bey, me i ba një visitë Arqipeshkvi. Masi ky Ministër çfaqti dishirin me u pa me krerët e Malsis, kje dash me i mbledhë kta e m’e pritë Ministrin ne nesre në nadje. Erdh Ministri e Malsorët ishin mbledhë në një odë të një shpis në Podgoricë për me u pa me Ministrin, ku e përcolla un si dragoman qi më pat shënjue Arqipeshkvi. Ishin n’at odë, për shka më bje në mend, Ded Gjo Luli, Ded Nika i Grudës, Vat Marashi e disa të tjerë.

Para se me hij Ministri, shkova te Malsorët e thaçë që të bashin një ndër ta, qi të flitet n’emën të gjithve. Danë Ded Gjo Lulin. Si hijmë n’at odë, Ministri u fal me ta e i thotë: Zotni kam ardhë prej Cetinet me ju pa. Ded Gjo Luli po i përgjigjet: S’na ka pasë marrë malli për ty. Mue m’u dote me ja përkthye. Si u ulmë e ndejmë, po i thotë Ministri: Mreti ju do e ju ka falë. Ded Gjo Luli nuk e la me marue e me i herë i tha: Mos na përmend Mretin pse s’kena punë me të. Aj as nuk na njef, as nuk i di punët të tona. Për ju qi vini mas Mretit, jeni të tanë hajna e menafikë, e ju e rreni si për ne si për të tjerët. Pranaj nuk ka shka na falë.

Atkohë Ministri sillet kahë un e më thotë: Po pveti kto Zotni at librin e kuq, qi kta përmendin, a e duen për vedi a për të gjithë Shqipënin? (Libri i kuq përbate disa pika, të cillat i ndieri Luigj Gurakuqi i kishte përgatitë për me ju lypë Mretit për Shqipëni).

Si e peveta Ded Gjo Lulin, aj përgjegji: Ato pika, qi janë n’at librin e kuq, i dona ma par për vedi, mandej për Shqipëni marë.

Ministri, i cilli gjatë kti Kuvendi nuk kishte mujtë me majtë gjakftohtësin, u çue mjaft idhnueshëm e më tha: Thueju se s’kam me ardhë ma me i pa. Me të marrë vesht kto fjalë Ded Gjo Luli, i ndej gadi e i tha: Kurr bojën mos ta pashim.

Kështu maroj ky kuvend pa kurrfarë’ kënaqsijet, si pat fillue.

Hotjanët ishin të pranishëm në të gjitha takimet e korrikut, që rezultuan pa sukses sepse kryengritësit nuk pranonin veçse pikat e parashtruara në Memorandumin e Greçës.⁵⁷

Së fundi, më 3 gusht 1911, ata reagueshan edhe njëherë kundër ofertës gjysmake të osmanëve. Në kancelaritë e Fuqive të Mëdha, të atyre ballkanike, si edhe autoritetet osmane, morën njoftim se fiset e Hotit e të Grudës nuk i pranuan kushtet e xhonturqve, Kastrati e Shkreli i pranuan, kurse Kelmendi hezitoi deri në arritjen e prijësve të tij. Por më 6 gusht, përballë presionit osman, presionit ndërkombëtar dhe atij të Malit të Zi, edhe hotjanët u detyruan të ktheheshin në trojet e tyre.⁵⁸

Më 30 korrik, ministri osman i akredituar në Cetinë, Sadedin Beu, bëri të njohura kundërpropozimet e qeverisë së tij ndaj kërkesave të kryengritësve. Në to shënohej se në Tuz do të caktohej një kajmekam i krishterë, që dinte gjuhën shqipe; të gjitha viseve kryengritëse do t'u njihej e drejta për të mbajtur armë, por me kusht që me to të mos qarkullohej në fshatra e në pazare; do të hapeshin shkolla shqipe, të cilat do të subvencionoheshin nga qeveria, do të ndërtoheshin rrugë në zonat malore; do të caktoheshin fonde për ndërtimin e shtëpive të djegura; refugjatëve deri në korrjet e reja do t'u siguroheshin një sasi e mjaftueshme misri; çdo mashkull mbi 15 vjeç me t'u kthyer në shtëpi do të merrte një lirë turke; si mydyr e këshilltarë do të shpalleshin edhe bajraktarët; shërbimi ushtarak do të bëhej në Stamboll për një vit, ndërsa pjesa tjetër në vilajetin e Shkodrës; xhelepi do të caktohej në raport me gjendjen ekonomike etj.⁵⁹

Nuk është objekt i këtij shkrimi të trajtojë rëndësinë e Kryengritjes së Malësisë së Madhe të vitit 1911. Me dy fjalë mund të thuhet se shqiptarët kishin evoluar cilësisht, se ata jo vetëm dinin të luftonin por edhe të bashkëpunonin, edhe të paraqiteshin me ndërgjegje politike të formuar, të shpalosur në programin ideor me kërkesa të rëndësishme

Ipeshkv i Lezhës

Luigj Bumçi (firma)

⁵⁷ *AIH*, Vj. 21-90, Raport i diplomatit austro-hungarez në Cetinë, dt. 7 korrik 1911 për MPJ, Vjenë; *Po aty*, Vj. 21-9-952, Telegram i Gisel për ambasadorin Pallavicini, dt. 24 korrik 1911. *Corriere d'Italia*, nr. 118, 11 korrik 1911, cituar sipas R. Abdylit, *Lëvizja kombëtare...*, f. 101.

⁵⁸ R. Gurakuqi, *Kryengritja...*, f. 149; S. Gjermëni, *Kryengritja...*, f. 56.

⁵⁹ R. Abdylit, *Lëvizja kombëtare...*, f. 113-114; Shih edhe E. Durham, *Brenga e Ballkanit...*, f. 238, e cila ishte e pranishme në takimin e zhvilluar.

mbarëkombëtare, dinin të përfitonin nga koniunkturat rajonale ndërkombëtare dhe aktivizonin diplomacinë europiane, për të gjetur mbështetje në luftën e tyre, për t'i bërë presion Perandorisë që të merrej më seriozisht me zgjidhjen e çështjes shqiptare. Edhe pse koncesionet e Stambollit ishin të pamjaftueshme dhe parciale, ato ishin preludi i një vazhdimësie pa kthim drejt zgjidhjes së afërt të problemit kombëtar shqiptar. Dhe me gjithë këto arritje të vitit 1911, sikurse në vitin jo të largët 1880, Hoti dhe prijësi i tij Ded Gjo Luli kishin një rol parësor të padiskutueshëm. Ky rol përcaktoi që Hoti, hotjanët dhe paria e tyre, me në krye Ded Gjo Lulin, jo vetëm përmenden në dokumentacionin diplomatik të kohës, por edhe të kenë aty një vend qendror. Falë pozitës gjeografike, që i bëri teatër kryesor të veprimeve luftarake, gjithashtu, për shkak të një ndërgjegjeje të spikatur për mbrojtjen e tokës dhe të drejtave të tyre, si ndaj Malit të Zi (veçanërisht në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit), ashtu edhe ndaj autoriteteve osmane xhonturke, që pa dhënë asgjë donin t'u merrnin çdo gjë malësorëve (çdo të drejtë të mëparshme); për faktin se në vitin e sprovës së madhe (1911) patën në krye Ded Gjo Lulin 70-vjeçar, plakun e urtë e luftëtarin e pashtruar, që bartte përvojën e paçmuar të viteve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (çka i dha mundësi të peshonte drejt politikën, si të xhonturqve, edhe të Malit të Zi, dhe të vendoste komunikimin dhe konsultimin e duhur me politikanët dhe intelektualët më të spikatur ndër atdhetarët e kohës, si I.Qemali, L. Gurakuqi, R.Siliqi, N.Ivanaj, etj. etj.). Hoti e hotjanët u ndodhën në syrin e ciklonit.

Pikërisht veprimtaria e veçantë e Hotit dhe hotjanëve, në Kryengritjen e Malësisë së Madhe të vitit 1911 i bëri ata të pranishëm jo vetëm në evidentimin kolektiv të zhvillimeve të kryengritjes, por edhe në evidentimin e përveçëm. Jo vetëm Austro-Hungaria, Italia, e padyshim Mali i Zi dhe Perandoria Osmane, kishin informacionin e detajuar për Hotin e hotjanët në dokumentacionin e kohës. Momente të veçanta janë pasqyruar edhe në dokumentet e të gjithë kancelarive të tjera. Pas viteve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Hoti dhe hotjanët, ndonëse një trevë dhe një popullsi e vogël në veri të trojeve shqiptare, në vitin 1911 do të linin përsëri gjurmë të dukshme në historinë e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ato janë të tilla që të bëjnë krenarë të gjithë gjeneratat e hotjanëve, të cilat erdhën pas këtyre viteve të stuhishme. Vlerësimi i I.Qemalit për prijësin e Hotit, që na vjen përmes traditës, se “Ded Gjo Luli është

pushka e ngrehur për Shqipëri ...”, është vlerësim për Hotin. Aty ka pjesën e vet çdo hotjan, dhe jo vetëm hotjani i asaj kohe...

S u m m a r y

THE ROLE OF HOTI IN THE UPRISING OF THE GREAT HIGHLANDS

The region of Hoti, recognized historically since medieval times, played an important role during the Albanian National Renaissance and early 20th century uprisings, which eventually led to the Declaration of Independence and later to the establishment of the Albanian state. Although a relatively small region and inhabited by a small number of people, the Hoti region and tribe are often mentioned in the diplomatic documents.

In crucial moments for the future of our nation, Hoti led by prominent figures such as Dede Gjo Luli, was positioned in support of our national interests. The insurrection of 1911 in the *Great Highlands* differed from previous uprisings in the fact that it did not put forward simple local demands but aimed at fulfilling national goals. The collaboration with prominent contemporary intellectuals, not only from the town of Shkodra but even with national figures, such as Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, Risto Siliqi, Nikolle Ivanaj, etc. gave it a special importance. A number of important documents such as the “Red Book” or the *Greca Memorandum*, the act of raising the national flag on the peak of Bratiles, in Deçiq, and other similar actions that were undertaken in the time span of several months, were examples of the *Great Highlands* insurgents’ vision, the vision of the Hoti people and the vision of Dede Gjo Luli himself. These demands pointed towards autonomy and the extraordinary sacrifices done to fulfill them impressed greatly the chancelleries of the Great Powers. The Albanians had evolved in their tactics, as now they knew not only how to fight but also how to collaborate and presented themselves with a well established political awareness which was introduced in their program of national requests. Now they knew how to benefit from the regional and international situation and also how to involve the European diplomacy to support their fight and to exercise pressure on the Empire in order to consider the Albanian issue seriously.

